



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI.

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritim Evropian

Mbledhja nr. 19.

Prishtinë, më 19.04.2018, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu- Kodra, Armend Zemaj, Fitore Pacolli, Fatmire Kollçaku, Ilir Deda, Zenun Pajaziti, Ahmet Isufi, dhe Milaim Zeka,.

Munguan: Fikrim Damka, Glauk Konjufca dhe Adem Hoxha.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrësit tjerë: përfaqësuesi nga GIZ, OSBE, NDI, KDI, Zyra e BE-së dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu- Kodra, kryetare e komisionit.

Kryetarja, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen e komisionit me këtë

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dt. 28.03.2018 dhe 30.03.2018;**
- 3. Diskutim me znj. Dhurata Hoxha, ministre e Integritimit Evropian, lidhur me raportin për vendin për vitin 2018;**
- 4. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit (PKZMSA) 2018-2022;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/ Prishtinën, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dt. 28.3.2018 dhe 30.3.2018

Procesverbalet e mbledhjeve të dt. 28.03.2018 dhe 30.03.2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Diskutim me znj. Dhurata Hoxha, ministre e Integritimit Evropian, lidhur me raportin për vendin për vitin 2018

Kryetarja i uroi mirëseardhje ministres dhe tha se tani kemi marrë raportin për vendin, për vitin 2018, në të cilin janë pasqyruar të arriturat dhe sfidat e institucioneve të Republikës së Kosovës, karshi obligimeve që i kemi marrë në rrugëtimin tonë evropian. Shihet se në këtë raport, në disa fusha është shënuar progres, por duhet një mobilizim i të gjitha institucioneve, për t'i adresuar sfidat që janë evidentuar.

Ne, si Kuvend, do të mundohemi t'i kryejmë obligimet tona ligjore që na takojnë. Komisioni për Integritime Evropiane do ta ketë, gjithsesi, prioritet mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, që kanë dalë si të gjetura në raportin për vendin. Për të diskutuar lidhur me këtë çështje, hapi debatin dhe fillimisht ia dha fjalën ministres.

Dhurata Hoxha, ministre e Integritimit Evropian, gjatë diskutimit të saj u fokusua në përmbledhjen e vlerësimeve më pozitive të theksuara në raportin për vendin për vitin 2018.

Si vlerësim pozitiv, janë vlerësuar zgjedhjet nacionale dhe lokale të vitit të kaluar, sepse janë mbajtur në mënyrë të rregullt dhe në një mjedis të shëndoshë konkurrues, në mes të partive politike. Po ashtu, e arritur tjetër, e nënvizuar në këtë raport është edhe ratifikimi i marrëveshjes së demarkacionit, si dhe të arriturat në administratë publike dhe rishikimin e agjencive dhe trupave të pavarura, progresi në zbatimin e pakos ligjore në integritimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në sistemin e drejtësisë, përfshirë edhe përparimet e bëra në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, njihen për trajtimin e rasteve të shënjëzuara.

Po ashtu, vlerësohet angazhimi ynë, në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Sa i përket kriterëve ekonomike, konstatohet se janë arritur rezultate shumë të mira në zhvillimin ekonomik, konkretisht është përmirësuar mjedisi afarist dhe Qeveria ka respektuar rregullin fiskal për deficitin buxhetor, eksporti ka shënuar rritje të ndjeshme, gjithashtu raporti ka shënuar përparime në përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Sa i përket standardeve evropiane, është shënuar progres në fushat kyçe të Acquis, si liria e lëvizjes së mallrave, tatimet dhe doganat, prokurimi publik, konkurrenca, si dhe në menaxhimin e migrimit të rregullt dhe ilegal.

Gjatë periudhës që mbulon raportin, jemi përballur me sfida dhe ka pasur ngecje.

Ministria e Integritimit Evropian ka koordinuar në përgatitjen e Programit Kombëtar për zbatimin e MSA-së 2018-2022, ku janë paraparë masat afatshkurtra dhe afatmesme, për të adresuar gjetjet e raportit të vendit. Gjithashtu, gjatë këtij viti, Ministria e Integritimit do të koordinojë takimet e strukturave të MSA-së, në kuadër të të cilave, përfaqësuesit e Komisionit Evropian do të diskutojnë për të gjeturat e raportit dhe masat që duhet ndër marrë për adresimin e tyre.

Kryetarja pyeti: Pasi ministria juaj ka rolin koordinues në këtë proces, cilat janë pikat kryesore, ku do të fokusoheni ju, si ministri, a do të takoheni me ministrinë e linjës dhe cilat janë masat?

Armend Zemaj, tha se është qartë se raporti nuk e ka marrë ende trajtimin institucional dhe ballafaqimit të argumenteve dhe interesimit të publikut, rolit të Kuvendit mbi të gjeturat, konkluzionet, sfidat dhe të arriturat eventuale që janë paraqitur.

Si çdo raport tjetër, edhe ky raport tregon dobësitë institucionale dhe synimin tonë, i cili është i fragmentuar në integrimin evropian dhe euroatlantik. Ne duhet ta shohim realitetin dhe të ballafaqohemi me të, si dhe të shohim ecjen e mëtutjeshme në vitin 2018. Atë që ju ministre po e quani progres, duhet të jemi korrekt dhe të sinqertë, sepse gjithçka flitet për progres që i takon vitit 2017, përpos ratifikimit të marrëveshjes me Malin e Zi. Kjo nënkupton se detyrimet që është dashur të përmbushen, janë të vogla, sidomos me atë që ne dëshirojmë ta shohim në luftimin e krimit dhe korrupsionit. Më lejoni që t'i listoj disa vërejtje që janë potencuar dhe ju duhet të mendoni se si do t'i qaseni, sepse ne si opozitë e dimë rolin tonë dhe pjesën e përgjegjësisë, por ju duhet të deklaroheni dhe të merrni për bazë, jo vetëm si ministri, por edhe si Qeveri, sesi do të mundësoni që së paku, këtë vit të arrihet liberalizimi i vizave dhe qartësimi i pozicionit tonë të partneritetit tonë me BE-në.

E filluar me zgjedhjet që kanë qenë të vlerësuara pozitivisht, por fragmentimi dhe polarizimi i vazhdueshëm politik kanë ndikuar negativisht në rolin e Kuvendit dhe rezultatin negativ të Qeverisë dhe kjo tregon krijimin e një klime të disbalancit mes pozitës dhe opozitës.

Sa i përket sundimit të ligjit dhe luftës kundër korrupsionit, raporti i BE-së 2018 nuk pasqyron ndonjë përparim të dukshëm, sa i përket përmbushjes së kriterëve, të cilat lidhen me reformat në drejtësi, për më tepër vihet në dukje vonesa e miratimit të pakos së ligjeve, si dhe brishtësia e sistemit gjyqësor në Kosovë, përballë ndikimeve politike. Andaj, lufta kundër korrupsionit mbetet ende sfidë e madhe e Qeverisë dhe raporti nuk pasqyron ndonjë të arritur të madhe në këtë drejtim, dhe krahasuar me raportin e vitit 2016, duket se ka ngecje.

Pjesa tjetër që theksohet si negative, është përpjekja e disa anëtarëve të Kuvendit për ta shfuqizuar Ligjin për dhomat e specializuara dhe prokurorin special, andaj është evidente dhe thelbësore që Kosova t'i përmbushë plotësisht detyrimet e saj ndërkombëtare në lidhje me dhomat e specializuara dhe prokurorin, ju tani e keni një përgjigje dhe krerët institucionalë që janë pjesë e grupeve të juaja politike në heshtje e kanë dhënë një deklaram të largimit nga kjo tendencë, por prapë është përmendur se ekzistojnë mëdyshje ndaj bartësve të këtyre institucioneve.

Te reforma në administratën publike, është politizimi i vazhdueshëm i administratës. Politizimi i vazhdueshëm i administratës publike mbetet jo vetëm shqetësim, por ndikon negativisht në efikasitetin dhe pavarësinë profesionale të administratës publike.

Kam insistuar që në kuadër të Komisionit për Integritet Evropian, të krijojmë një raport kushtetues me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial dhe t'i shohim sfidat dhe kërkesat e tyre, sepse në raport thuhet se ende sistemi gjyqësor i Kosovës është në një fazë të hershme dhe janë arritur disa përparime, pjesërisht në zbatimin e ligjeve të paketës së drejtësisë, vetëm nga viti 2015 dhe gjyqësori është ende i prekshëm nga ndikimet e panevojshme politike në institucionet e sundimit të ligjit, andaj ne nuk dëshirojmë që të kemi një drejtësi të ngadalshme dhe joefikase dhe kjo tregoi si me liberalizimin e vizave dhe në ecjen e mëtejme të Republikës së Kosovës në integrimin në strukturat euroatlantike.

Ahmet Isufi, tha se ne, sapo e kemi marrë raportin dhe ka nevojë për një zbërthim më të detajuar nga ana e komisionit dhe deputetëve, në përgjithësi, ku do ta kemi një seancë, në të cilën do të diskutojmë shumë më gjerësisht, por në mënyrë të përgjithësuar, atë që kemi mundur ta shohim në këtë raport, është një vlerësim, që së paku, nga secili prej nesh, që kemi një ecje përpara, sa i përket ndryshimeve që kanë mundur të ndodhin gjatë një viti, e që normalisht, këtu ka të bëjë, sidomos me institucionet demokratike, të cilat në fakt kemi rastin e zgjedhjeve që janë vlerësuar shumë lart, pastaj në gjyqësi dhe prokurori kemi ndryshimet që janë fillestare, por me domethënie dhe pakoja ligjore që është ofruar do të bëjë ndryshime pozitive, në këtë drejtim.

Ato që janë elemente kryesore, mendoj që janë një angazhim i institucioneve me një disiplinë dhe administratë më me performancë, njëkohësisht edhe një angazhim në aspektin e mbulimit të resorëve që kanë pasur handicap në të kaluarën dhe tani ka një ndryshim në aspektin pozitiv. Ajo që duhet të na bëjë neve më të vëmendshëm, jo vetëm për përmbushjen e kriterëve për hir të liberalizimit të vizave, por për ndryshimin e jetës në Kosovë, funksionimin e institucioneve dhe funksionimin e shtetit në tërësi. Pra, ky do të duhet të jetë interesimi ynë i parë, dhe duke rregulluar gjithë sistemin tonë brenda, do të kemi mundësi ta kemi një performancë shumë më të mirë në arenën ndërkombëtare. Normalisht, ju duke qenë ministre për Integrim Evropian, e keni rolin shumë dominues, në këtë drejtim dhe duhet që bashkërisht me komisionin parlamentar, me institucionet që lidhen me integrimet, mos të bëjmë vetëm improvizime, por përkundrazi, thellësisht duhet të ndryshohen gjërat, në mënyrë që të kemi një ecje përpara të Kosovës.

Fitore Pacolli, i tha ministres, se ty të bie barra e dyfishtë për dështimin e raportit, sepse keni qenë ministre e Drejtësisë, gjatë kohës kur ky raport i përmbledh ngecjet e Kosovës dhe tani ministre e Integritimit Evropian. Pra, për këtë duhet dhënë një përgjegjësi, pse është një raport i tillë?

Sa herë keni raportuar para komisionit, raportimet e juaja kanë qenë sipërfaqësore dhe gjithmonë keni thënë se jemi duke ecur shumë mirë me reformën e agjendës evropiane, ndërsa raporti konstaton se ka dështim dhe mbetje prapa, sa i përket avancimit në reformën evropiane.

Pra, kemi ngecje dhe këto ngecje asnjëherë nuk janë raportuar në komision dhe Kuvend. Po ashtu, e njëjta mbetet edhe me MSA-në, nëse i marrim të gjitha intervistat tuaja, ku nëpër media thohet se kemi ecur shumë mirë me MSA-në, kurse raporti po e thotë krejt të kundërtën, prandaj kisha dashur një përgjigje, pse nuk keni raportuar saktë dhe pse keni manipuluar edhe me neve si deputetë, sepse ne kemi besuar që sa i përket reformave në agjendën evropiane dhe MSA-së, po ecim mirë, po ashtu në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, që i ka përmbushur Kosova kushtet, keni sjellë në Kuvend marrëveshjen për demarkacionin, duke bërë që ne t'i falim mbi 8200 hektarë.

Raporti konstaton se luftimi i korrupsionit është një sfidë për Kosovën dhe mbetet shqetësim. Keni thënë se ka progres në regjistrin e dëshmimeve, në raport thuhet se ca progres është shënuar, por numri i konfiskimeve mbetet i vogël, pra është i pamjaftueshëm. Raporti tërheq vërejtjen, te numri i dënimeve përfundimtare dhe hetimeve financiare dhe konfiskimi i aseteve mbetet i vogël. Pra, ju rrjedhimisht keni gënjyer qytetarët e Kosovës, se ju keni plotësuar kriteret.

Ne mbledhjen e kaluar e kemi sjellë raportin e 3 ekspertëve dhe iu treguam se si është realiteti. Ju na thohet se ky raport nuk merret parasysh, sepse është raport i 3 ekspertëve të pavarur që kanë bërë studimin, por janë marrë parasysh, sepse shumë gjëra që ende i mbani të fshehura, i ka disa gjëra të njëjta. Raportin ua kam dorëzuar

unë deputetëve dhe kërkoj përgjigje, pse nuk ua keni dorëzuar deputetëve raportin nëpër email-et e tyre zyrtare?

Keni qenë ministre e Drejtësisë, keni dështuar. Raporti thotë se sistemi i drejtësisë mbetet në një fazë të hershme dhe është arritur ca progres në implementimin e pakos ligjore 2015. Çka keni bërë prej vitesh, kur keni marrë edhe Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Integritimit Evropian, për të implementuar këtë pako? Pra, jemi mbrapa, gjyqësori mbetet i cenueshëm dhe ka shumë ndërhyrje politike. Pra, për të gjitha këto dështime, ministre duhet të jepni llogari sot. Pse na keni thënë të pavërtetën?

Ilir Deda, tha se kur u publikua Raporti i Progresit, isha në Berlin dhe ajo që e ndihmoi vizitën tonë atje, ishte që shumica e kritereve për liberalizim të vizave janë plotësuar, kurse raporti për vendin është i keq dhe se kemi pritur se do të dalë ndryshe. Por, prioritet ministre, është që sa më shpejt gjatë këtij muaji ta miratojmë Ligjin për konfiskimin e pasurisë, sepse jemi në trenin e fundit për liberalizim të vizave dhe në maj dhe gjatë verës duhet të shkojmë në 3 apo 4 shtete të BE-së, në mënyrë që të kemi vendim pozitiv nga shtetet anëtare.

Liberalizimi i vizave është përgjegjësi, jo vetëm e një ministrie, por e të gjitha institucioneve të Kosovës, të paktën Alternativa me LDK-në, nuk do ta rrezikojnë këtë proces dhe do të vazhdojmë me lobim, nëse duam të kemi vendim pozitiv të shteteve anëtare në gjysmën e dytë të këtij viti.

Në vazhdim, i tha ministres se duhet të kërkonin zyrtarisht, nga pjesët e tjera të Qeverisë, që ta rrisin me një vendosmëri shumë më të madhe luftimin e krimit dhe korrupsionit. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me liberalizimin e vizave, por ka të bëjë me kredibilitetin e shtetit, sepse po ndikon edhe në sferat e tjera, me në fund duhet të bëhemi më të përgjegjshëm dhe më koshientë, karshi një situatë jo fort të favorshme.

Milaim Zeka, theksoi se fajtor për mosliberalizimin e vizave është edhe opozita, por nuk duan ta kuptojnë, sepse liberalizimi i vizave është interes jetik kombëtar për qytetarët e Kosovës. Ne e dimë se vendimi për liberalizimin e vizave është vendim politik dhe shumë kritere nuk i kanë plotësuar, si p.sh Ukraina apo Moldavia dhe për kritere nuk kishte për të hyrë Rumania, Bullgaria në BE edhe për dymijë vite, por e mira është se në këtë luftë mes lindjes dhe perëndimit dhe ku fuqia jonë e madhe orientuese drejt perëndimit e përcakton edhe agjendën politike të Brukselit dhe Uashingtonit, për të zbutur dominimin rus dhe serb në Ballkan, do të thotë që ne do të jemi të pranueshëm dhe do të lëvizim lirshëm, se a i kemi kryer detyrat e shtëpisë apo jo, do të flasim pas liberalizimit të vizave. Më vjen keq që ende thirrmi në karta patriotike, qoftë edhe për demarkacionin, sepse ende nuk e dimë se a kemi humbur apo kemi fituar territor. Ne nuk kemi probleme me Malin e Zi, sepse për ne nuk paraqet kurrfarë kërcënimi. Ne kemi probleme, pas liberalizimit të vizave, për të luftuar korrupsionin brenda Kosovës dhe mos të harrojmë znj. Ministre, për hir të asaj që ju personalisht jeni e liruar nga frika, se dikush do t'ju akuzojë për korrupsion. Fenomeni i çështjes së korrupsionit është i përhapur në gjithë Evropën, sepse krejt këtë sistem korruptiv në Kosovë e ka ndërtuar UNMIK-u dhe EULEX-i. Ne duhet t'u themi hapur këtyre të BE-së, mos na mbështetni për muri. Unë jam i lumtur që kriteret kryesore për liberalizimi janë plotësuar dhe ne do të vazhdojmë për ta luftuar krimin dhe korrupsionin, por kjo do të na merr kohë, sepse që 200 vite, në vendet skandinave flitet për korrupsion, por ka korrupsion edhe në këto vende, prandaj mbi bazën e kësaj, ju përgëzoj si ministre, për qëndrimin, lobimin dhe punën tënde dhe do ta keni mbështetjen tonë, si në Bruksel, ashtu edhe në takimet tona me delegacione, diplomatë, sepse ne nuk dëshirojmë që qytetarët e Kosovës të mbesin edhe më tej të izoluar dhe

besoj që deri në fund të vitit, të rinjtë tanë mund të dalin jashtë dhe të mësojnë, sa që së paku në zgjedhjet e ardhshme të dinë kë të votojnë e kë jo.

Fatmire Kollçaku, tha se Raportin e Progresit nuk duhet shikuar vetëm në kontekst të liberalizimit të vizave, sepse nëse i shikojmë prononcimet e para të zyrtarëve të BE-së, ku znj. Apostolova e thekson se krimi i organizuar dhe korrupsioni mbeten endemikë.

Përkundër faktik që deri tani është thënë se përfundimi i demarkacionit me Malin e Zi do të ishte si kusht kryesor, por e vërteta po mbetet, sepse problemi më i madh ende është krimi dhe korrupsioni. Qeveria, para këtij fakti, duhet të jetë shumë e vëmendshme dhe të ndër marrë hapa dhe të japë prova bindëse dhe të fillojë nga vetja, vetëm atëherë do të japim prova bindëse që, si shtet, jemi të vendosur që t'iu ndihmojmë qytetarëve të lëvizin lirshëm dhe do t'iu ndihmojmë shtetit që të ecë përpara edhe në aspekte tjera.

Nëse e shikojmë raportin e vitit 2016, me këtë të fundit, do të shohim që ka regres, sepse ka rritje të papunësisë dhe Kosova mbetet vendi më i varfër në rajon, dhe nëse ia shtojmë edhe një konstatim tjetër, se nuk është shënuar asnjë përparim në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe trajtimin e boshllëqeve të aftësive në tregun e punës, kjo nënkupton që do ta vështirësojë, sepse shtetet duhet të japin veç e veç vendimin, sepse dihet se askush nuk dëshiron që ta vërshojnë qytetarët e një shteti, ku papunësia shënon kaq rritje të madhe dhe varfëria është në rritje. Liberalizimi nënkupton që të shkohet në shtetet e perëndimit për shëtitje dhe vizita, nëse kanë familjarë atje dhe nëse kanë një konto të mirë, por kurrsesi të jenë konkurrues në tregun e punës, por fatkeqësisht varfëria do t'iu detyrojë të ikin.

Qëllimi ynë nuk është t'iu detyrojë të ikin, por qëllimi ynë është të lëvizim lirshëm, të mbesim këtu dhe t'iu kontribuojmë shtetit tonë.

Më tej, në raport është shënuar se sektori i energjisë vazhdon të përballet me sfida serioze dhe asnjë përparim nuk është arritur për të adresuar çështjet mjedisore dhe është për keqardhje, sepse në këtë drejtim nuk ka asnjë lëvizje fare.

Sa i përket zgjedhjeve, ministrja tha se është shënuar përparim, por në aspektin gjinor raporti thekson se ende mbeten mospërputhje mes kornizës ligjore për zgjedhjet dhe dispozitës për përfaqësim të barabartë të Ligjit për barazi gjinore, si dhe theksohet se duhet të merren veprime afirmative, për të tejkaluar barrierat që i pengojnë gratë, që të marrin pjesë në politikë dhe të zgjidhen.

Një segment i veçantë i kushtohet edhe Kuvendit. Me të vërtetë nuk jemi shumë efektivë në mbikëqyrje të Qeverisë dhe këtu duhet të jemi autokritikë. Po ashtu, është theksuar se Qeveria është tepër e madhe dhe për këtë jemi të vetëdijshëm dhe e kemi theksuar gjithnjë numrin e madh të zëvendësministrave, këshilltarëve dhe kjo ndikon në politik bërjen dhe në seanca kemi mungesë të ministrave dhe zëvendësministrave, kur shqyrtohen ligje të rëndësishme. Po ashtu, është konstatuar se ka ngecje në implementimin e MSA-së dhe në implementimin e ERA-së. Raporti, edhe këtë vit e thekson se politizimi i administratës publike mbetet shqetësim serioz dhe kjo ndikon negativisht në efikasitetin dhe pavarësinë profesionale të administratës publike. Ky është një fakt për keqardhje dhe ky konstatim qëndron sot e ca vite. Pra, mbesin shqetësime për rekrutime jomeritore dhe jokuompetente dhe kriteri i vetëm është ai politik, për punësime. MAP ende nuk ka kapacitete të mjaftueshme për mbikëqyrje aktive të procedurave të rekrutimit.

Sa i përket gjyqësorit, u fol shumë, theksohet se ende ndikohet nga ndërhyrjet e panevojshme politike dhe administrimi i drejtësisë mbetet i ngadalshëm dhe joefikas.

Fitore Pacolli, tha se si Lëvizje Vetëvendosje, kemi punuar jashtëzakonisht shumë, për t'i shtyrë përpara proceset pozitive për Kosovën. Pra, projektligji, të cilën e kërkoje, Ilir, ta iniciojë ministria, e ka iniciuar Vetëvendosja, më dt.29 mars të këtij viti.

Ilir Deda ndërhyri dhe tha se unë e kam bërë kornizën në vitin 2015.

Fitore Pacolli vazhdoi diskutimin dhe tha se nuk kemi informata se e ke prurë kornizën, pikërisht në luftën e krimit dhe korrupsionit. Në raport, në faqen 18, thuhet se nuk ka përparim dhe ka ngecje dhe rekomandohet të miratohet pakoja ligjore, sa i përket suspendimit dhe largimit nga pozita publike të zyrtarëve të lartë. Më tutje, Raporti i Progresit nuk flet vetëm për liberalizimin e vizave, por flet edhe për rrugën tonë drejt integritimit evropian, prandaj ne duhet të ndalemi dhe ta shqyrtojmë, se cila do të jetë marrëdhënia e Kosovës me BE-në, pra çka paraqet Raporti i Progresit, sepse nuk është i vetëm liberalizimi, si do t'iu qasemi 5 shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën. Pra, këtu nuk ka progres dhe këtë çështje duhet ta ngremë. Ne, si shtet, jemi fokusuar vetëm te zbatimi i MSA-së, në të cilën kemi ngecur mbrapa.

Kryetarja, tha se nuk është mirë që asnjëri prej deputetëve të lëshohen në deklarata manipuluese në opinionin, sepse këto deklarata e dëmtojnë rrugën tonë evropiane dhe raporti nuk mund të shihet bardh e zi, sepse i ka edhe anët pozitive, edhe anët negative, të cilat do t'i marrim dhe do t'i trajtojmë, por është evidente se është bërë progres i theksuar në raport për liberalizimin e vizave, rezultatet janë pozitive dhe presim që do të kemi rekomandim pozitiv, sa i përket liberalizimit të vizave. Raporti evidenton edhe fragmentimin dhe polarizimin e theksuar që ka ndodhur në Kuvend edhe gazin lotsjellës dhe aplikimin e marrëveshjes së demarkacionit, që i ka hapur rrugën liberalizimit të vizave dhe askund, në raport nuk ceket sa hektarë tokë i kemi humbur.

Ministrja, tha se veç kemi filluar që në mbledhjet e Qeverisë të jetë një pikë e rendit të ditës, lidhur me agjendën evropiane dhe procesin e integritimit evropian. Aty, në mënyrë të detajuar, raportohet për të arriturat dhe ngecjet nëpër ministri dhe për këtë do të jemi më të zëshëm, angazhim në mbledhjet e Qeverisë kërkon edhe Kryeministri. Po ashtu, pajtohemi se duhet të jemi të sqerterë për arritjet dhe sfidat, por mos t'i keqinterpretojmë deklaratat, qoftë të miat apo të zyrtarëve të lartë, nuk është e ndershme të ndërlidhet raporti i vendit me procesin e liberalizimit të vizave. Pra, duhet të bëhet ndarja se procesi i liberalizimit të vizave i ka pasur 95 kriteret, të cilat i kemi plotësuar dhe tani i mbetet ekipit vlerësues, i cili do të vijë së shpejti ta vlerësojë edhe kriterin e luftimit të krimit dhe të korrupsionit. Këtu kemi pasur progres dhe prapë mbetem pas deklarimeve të mia, që liberalizimi i vizave do të ndodhë deri në fund të këtij viti. Nuk duhet të ndërlidhet raporti i 3 ekspertëve, që u përmend, sepse nuk ka të bëjë me raportin e vendit, por është raport që ekipet e ekspertëve e vlerësojnë në secilin vend dhe jo vetëm te ne.

Në shumicën e kapitujve të raportit, thuhet se ka pasur progres, pak progres, ca progres ose shumë progres, por veçohet kapitulli, ku thuhet se në zhvillimin ekonomik kemi pasur shumë progres, por gjithashtu duhet të jemi realë dhe duhet t'i përmendim edhe sfidat.

Në fund, përsëriti se ky raport nuk duhet të manipulohet në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave, sepse ky raport është udhërrëfyes për ne, sa i përket integritimit evropian, në përgjithësi, raporti patjetër që duhet të ketë zhvillime. Këtu shënohet edhe si progres, pakoja e ligjeve, e miratuar dy javë më parë, nuk është mirë të manipuloni, sepse asnjëherë nuk kam thënë se është plotësuar agjenda evropiane e reformave, sepse

gjithmonë kam qenë kritikuese, ku kam thënë se vetëm dy kritere i kemi plotësuar nga 22 kriteret dhe kam kërkuar konsensus që sa më shpejt të ecim në këtë drejtim. Pajtohem gjithsesi që Ligji për barazinë gjinore duhet implementuar sa më mirë dhe është fatkeqësi shumë e madhe që nuk ka pasur gra candidate për kryetare të komunave dhe mendoj se ka më shumë hapësirë për zbatimin e këtij ligji dhe të avancohet agjenda e barazisë gjinore.

Armend Zemaj, tha se të gjitha këto që u potencuan, znj. ministre kërkon një bashkërendim institucional. A keni një plan konkret, pas marrjes së raportit dhe si i parashihni ju, të gjitha këto të gjetura dhe çfarë afati kohor do t'u jepni institucioneve përkatëse, që janë të obliguara që së paku, pak a shumë t'i eliminojnë defektet apo të fillojnë përmirësimin e tyre?

Ministrja, tha se e përmenda edhe shkurtimisht që ne e kemi analizuar raportin e vendit, i kemi nxjerrë rekomandimet që dalin nga ky raport dhe kemi një afat kohor, sepse imputi i radhës për raportin e vitit të ardhshëm, do të fillojë në shtator dhe ne duhet të arrijmë sa më tepër dhe duhet të kemi një bashkërendim sa më tepër me Kuvendin, që ligjet mos të na mbesin nëpër komisione, siç kemi raste, përjashtuar Komisionin për Integritet Evropian, me të cilin kemi një bashkëpunim dhe një përkrahje të madhe.

Të gjitha institucionet, prej të cilave i marrim imputet, duhet të jemi sa më dinamikë në punën tonë.

Kryetarja, tha se duke pasur parasysh rëndësinë e këtij dokumenti dhe duke pasur parasysh diskutimet, ne rekomandojmë që raporti për vendin të diskutohet në seancën e radhës. Po ashtu, lidhur me këtë raport ka edhe një kërkesë prej 40 deputetëve nënshkrues, që të diskutohet në seancën plenare.

4. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2018-2022

Kryetarja, tha se programi kombëtar paraqet një kornizë gjithëpërfshirëse të reformave konkrete afatshkurta dhe objektivat afatmesme për periudhën 2018-2020, për zbatimin e MSA-së.

Një pjesë e tyre u diskutua sot nga anëtarët e komisionit. Miratimi dhe zbatimi i këtij dokumenti nënkupton përcaktimin e prioritetëve dhe masave, jo vetëm për përafrim të legjislacionit, por edhe për zbatim të politikave të institucioneve. Duke pasur parasysh se koordinimin në procesin e rishikimit këtij dokumenti, pikërisht e ka bërë Ministria e Integritet Evropian, ia jap fjalën ministres.

Ministrja, tha se ky dokument është strategjik kombëtar për zbatimin e agjendës evropiane dhe është rishikuar për herë të dytë, që nga hyrja në fuqi e MSA-së dhe mbulon periudhën 2018 -2022. Ky program 5 vjeçar është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet relevante zbatuese dhe përmban masa afatshkurta për këtë vit dhe objektiva të prioritetëve afatmesme, për t'u arritur deri në vitin 2022. Aty jemi fokusuar në 3 aspekte strategjike të aderimit në BE, përmbushjen e detyrimeve të mëdha, përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së dhe zbatimin e legjislacionit të përafruar përmes avancimit të politikave, reformave institucionale dhe ngritjes së kapaciteteve dhe zbatimin në praktikë. Programi parasheh masa konkrete, në kuadër të 33 kapitujve të Acquis, që përmban gjithsej 534 masa, nga të cilat 147 janë

masa legislative dhe 387 janë masa zbatuese. Ky dokument nuk ka vakum buxhetor, që do të thotë se i gjithë planifikimi financiar është i buxhetuar. Ky plan është i harmonizuar edhe me planin vjetor të punës së Qeverisë, posaçërisht në planin legjislativ, ku 95% e projektligjeve veç janë të parapara në programin legjislativ. Reformat e parapara me këtë program, gjatë këtij viti dhe gjatë dy viteve të ardhshme, janë të rëndësishme, sepse kemi marrë për obligim edhe përkrahje të drejtpërdrejtë financiare e buxhetore, përmes IPA fondeve, posaçërisht në reformën e administratave publike, prandaj në këtu kemi paraparë objektiva specifike, se sa duhet përmbushur ky program.

Kryetarja hapi debatin dhe pastaj e hodhi në votim.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Rekomandim

Miratohet Programi Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2018-2022 dhe i rekomandon Kuvendit për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor, lidhur me Projektligjin, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional. Sa i përket legjislacionit të Bashkimit Evropian, çështjet fetare nuk janë objekt i rregullimit specifik me akte juridike të Acquis të BE-së, andaj kjo fushë mbetet kompetencë e rregullimit të brendshëm të shteteve anëtare.

Konstatojmë se dispozitat e këtij projektligji, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, nuk cenojnë parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Kryetarja hapi debatin dhe pas votimit, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk cenojnë parimet e përgjithshme të BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/ Prishtinën, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor, lidhur me projektligjin, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional. Ky projektligj nuk rregullohet me akte juridike të Acquis të BE-së, andaj kjo fushë mbetet kompetencë e rregullimit të brendshëm të shteteve anëtare.

Konstatohet se dispozitat e këtij projektligji, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, nuk cenojnë parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Kryetarja hapi debatin dhe pas votimit, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk cenojnë parimet e përgjithshme të BE-së, andaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

7. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30.

Përgatitur nga:
Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetare e komisionit,
Blerta Deliu- Kodra
